

Aplikimi për strehim të përballeshëm: Udhëzues për të ardhurat e aplikantit

NYC Housing Connect: Udhëzues për të ardhurat

[FRONT/PAGE 1]

RRETH KËTIJ UDHËZUESI

Të **ardhurat tuaja** janë një pjesë e rëndësishme e aplikimit për strehim të përballeshëm. Ky udhëzues ju tregon se si llogariten të ardhurat tuaja për strehim të përballeshëm. Ky nuk është një aplikim për strehim. Nuk do t'ju tregojë nëse do të merrni një apartament. Mirëpo mund t'ju ndihmojë t'u përgjigjeni saktë pyetjeve rreth të ardhurave tuaja. Nëse ftoheni në **takim për të konfirmuar kualifikimin**, do t'ju duhet të merrni me vete dokumente që konfirmojnë informacionin në aplikimin tuaj.

Shumë prej fjalëve dhe shprehjeve kryesore shpjegohen në faqen 10, "Terma ndihmëse". Në brendësi të këtij udhëzuesi ato shfaqen si **referenca (me shkrim të theksuar e të pjerrët)**.

BRENDA UDHËZUESIT:

- ▶ Çfarë janë të ardhurat? faqe 2
- ▶ Cilat të ardhura përfshihen? faqe 3
- ▶ Të ardhurat nga punësimi: faqe 4
- ▶ Të ardhurat nga vetëpunësimi: faqe 5
- ▶ Të ardhurat nga burime të tjera: faqe 7
- ▶ Të ardhura që nuk përfshihen: faqe 8
- ▶ Pyetjet të shpeshta: faqe 9
- ▶ Terma ndihmëse: faqe 10

Mohim i përgjegjës: Ky dokument ka për qëllim të ofrojë vetëm informacione të përgjithshme. Përmbajtja e tij bazohet në Manualin e "HUD" 4350.3 për Zënien e Banesës dhe në Udhëzimet e Marketingut të HPD-së (Departamenti i Ruajtjes dhe Zhvillimit të Strehimit) dhe të HDC-së (Korporata e Zhvillimit të Strehimit). Shembujt e të ardhurave nuk përshkruajnë të gjitha situatat e mundshme financiare.

[PAGE 2]

ÇFARË JANË TË ARDHURAT?

A përfitoni para nga...

- Një punë apo më shumë se një punë?
- Jeni i vetëpunësuar? Për shembull: Shofer taksie, stilist flokësh, artist i pavarur
- Burime të tjera, të rregullta? Për shembull: Përkrahje financiare për fëmijët, përfitime të papunësisë, të ardhura të sigurimit suplementar (SSI), pension

Këto para janë **të ardhurat tuaja**. Për të aplikuar për strehim të përballueshëm do t'ju duhet të dini se sa të ardhura merrni.

HAPAT PËR TË LLOGARITUR TË ARDHURAT:

1. Identifikimi i të gjitha burimeve të të ardhurave:

- Të ardhura nga punësimi (f.4)
- Të ardhura nga vetëpunësimi (f.5)
- Të ardhura nga burime të tjera (f.7)

2. Konvertimi i pagave në të ardhura vjetore të përgjithshme.*

1. Pagesat për orë të paguara nga punëdhënësi para taksave dhe zbritjeve të tjera
2. Të ardhurat bruto në listëpagesën e pagës (të paguar çdo javë, çdo dy javë, etj.)

**Paratë e marra nga vetëpunësimi duhet të llogariten si të ardhura neto, ato janë shumat pasi zbriten shpenzimet e ushtrimit të biznesit dhe shpenzimet e tjera.*

3. Mblidhni të ardhurat nga të gjitha burimet për të marrë një shumë të përgjithshme të të ardhurave vjetore.

Të ardhurat mund t'i përfitoni në mënyra të ndryshme.

Disa shembuj:

- Rroga çdo 2 javë
- Bakshishet për çdo turn
- Çdo lloj pagese javore ose mujore, si përkrahja financiare për fëmijët, pensioni, ose përfitimet e papunësisë
- Paga për ditët e pushimit

Me të ardhura mund të nënkuptojmë shumë gjëra.

Disa shembuj:

- Paga
- Pagesa me orë
- Fitimet
- Pagesat

Të gjitha këto para quhen **të ardhura**. Ato duhet t'i përfshini në aplikimin për strehim të përballeshëm. Nëse shkoni në një **takim për të konfirmuar kualifikimin** për strehim të përballeshëm, do t'ju duhet të merrni dokumente për të konfirmuar të ardhurat tuaja.

Mos harroni

Në këtë udhëzues, mund të gjeni më shumë informacion për fjalët **e shënuara si referencë (me shkrim të theksuar e të pjerrët)** në faqen 10, "Terma ndihmëse".

CILAT TË ARDHURA PËRFSHIHEN?

Janë 3 lloje kryesore të të ardhurave për aplikimin për strehim të përballeshëm.

1. Të ardhurat nga punësimi

Paratë që ju paguhen nga punëdhënësi. Këtu përfshihen bakshishet, shpërblimet, pagesat për punën jashtë orarit, dhe lloje të tjera të pagesave. Nëse plotësoni një formular deklarimi W-2, paratë e deklaruara aty janë **të ardhurat nga punësimi**. Në aplikim, përfshini shumën *para* zbritjes së taksave ose të parave të tjera (**të ardhurat bruto**).

Për shembull:

- Paga vjetore
- Pagesa për orë, duke përfshirë paratë në dorë, të paguara **rregullisht**. Për shembull: Çdo javë, çdo 2 javë, dy herë në muaj, çdo muaj
- **Puna rastësore ose episodike** për një punëdhënës të caktuar. Për shembull: Puna në fundjavë për një shoqëri shërbimi katering, puna "Per diem" (ditore) për kujdes shëndetësor në një spital ose agjenci
- Puna sezonale. Për shembull: Shitjet me pakicë gjatë sezonit të pushimeve, puna në sezonin e verës për një shoqëri për ndërtimin e çative
- Bakshishet
- Pagesa e pushimeve
- Pagesa për punën jashtë orarit
- Shpërblimet dhe komisionet që merrni rregullisht

2. Të ardhurat nga vetëpunësimi

Të gjitha paratë që merrni çdo vit nga vetëpunësimi, puna e pavarur, ose si një kontraktor i pavarur. Në aplikim përfshini shumën *pas* zbritjes së shpenzimeve të ushtrimit të biznesit dhe të ndalesave të tjera (**të ardhurat neto**).

Për shembull:

- "Të ardhurat (ose humbjet) nga biznesi" në deklaratën tatimore
- Të ardhurat nga zotërimi i biznesit
- Puna e pavarur. Për shembull: Shkrimtar ose artist i paguar drejtpërdrejt nga klientët
- Të qenit një kontraktor ose konsulent i pavarur
- Të qenit një ofrues shërbimi i pavarur. Për shembull: Shofer taksie i cili posedon/merr me qira taksinë, Stilist flokësh që merr me qira një hapësirë në një sallon bukurie
- Puna sezonale ose rastësore. Për shembull: Pastruese shtëpie e paguar direkt nga pronari, drejtimi i biznesit tuaj të kateringut gjatë sezonit të verës

3. Të ardhurat nga burime të tjera

Të gjitha paratë që ju paguhen rregullisht gjatë një viti, por jo nga puna. Për shembull: përkrahja financiare e fëmijës, përfitimet nga sigurimet shoqërore, përfitimet nga sigurimi për papunësinë, ose pagesat e interesit. Në aplikim, përfshini të ardhurat nga burime të tjera, vetëm nëse i përfitoni ato **rregullisht** (çdo javë, çdo muaj, çdo vit, etj.).

Për shembull:

- Ndihma ushqimore
- Pagesat për pensione vjetore
- Rezerva të Forcave të Armatosura
- Asistenca e fëmijëve

- Dividendët
- Pagesa për personat me aftësi të kufizuar
- **Të ardhurat nga dhurimet**
- **Interesat nga asetet**
- Pensioni
- Ndihma shtetërore (PA)
- Të ardhurat nga pronat e dhëna me qira
- Sigurimet shoqërore ose SSI
- Përfitimet e papunësisë
- Asistenca e mirëqenies sociale
- Shpërblimi i punonjësit

[PAGE 4]

1. TË ARDHURAT NGA PUNËSIMI

Të ardhurat nga punësimi janë paratë që përfitoni nga një punë. Ato janë të ardhurat që ju paguhen nga punëdhënësi, para zbritjes së taksave ose ndalesave të tjera (**të ardhurat bruto**). Në aplikim përfshini shumën për një vit të plotë (**të ardhurat vjetore**). Për të mësuar rreth përfshirjes së të ardhurave që përfitoni nga biznesi që keni në pronësi, shkoni në f. 5, "Të ardhurat nga vetëpunësimi".

A përfitoni ju ose çdokush që jeton me ju të ardhura nga...?

- Paga vjetore
- Pagesa për orë, ditë ose javë
- Pagesa me para në dorë
- Bakshishet
- **Puna rastësore ose episodike** për një punëdhënësi *Për shembull: puna ditore për një shoqëri katering, punët e kujdesit shëndetësor për një spital ose agjenci*

- Puna sezonale. Për shembull: Shitjet me pakicë gjatë sezonit të pushimeve, puna në sezonin e verës për një shoqëri për ndërtimin e çative
- Pagesa e pushimeve të paguara, pagesat për punën jashtë orarit, shpërblimet ose komisionet

Këto janë burimet e **të ardhurave nga punësimi**. Nëse i jeni përgjigjur me "po" njërës prej të mësipërmeve, përfshini shumat në pjesën e aplikimit "Të ardhurat nga punësimi".

SI LLOGARITEN TË ARDHURAT VJETORE

Është e rëndësishme që t'i shtoni të gjitha të ardhurat tuaja në një shumë të përgjithshme vjetore. Nëse paguheni rregullisht (si p.sh. çdo javë, çdo 2 javë, dy herë në muaj, etj.), duhet të ndërmerrni këto hapa të rëndësishme për të llogaritur **të ardhurat vjetore**.

Shënim: Nëse aplikoni në faqen e internet "NYC Housing Connect", nuk keni pse ta bëni këtë llogaritje. Ajo do të bëhet automatikisht pasi të keni plotësuar informacionin e të ardhurave në profilin tuaj.

Opsioni 1: Konvertimi i pagesave për orë në të ardhura vjetore:

Shumëzoni (shumën në \$ që fitoi për 1 orë) herë (numrin e orëve që punoni në 1 javë) herë (# javët që punoni zakonisht në 1 vit) = **të ardhurat vjetore**.

Opsioni 2: Konvertimi i pagesave të rregullta për orë në të ardhura vjetore.

Sa shpesh paguheni?

- Çdo javë: Shumëzoni shumën në \$ që paguheni për javë herë 52 = të ardhurat vjetore
- Çdo 2 javë: Shumëzoni shumën në \$ që paguheni për çdo 2 javë herë 26 = të ardhurat vjetore

- Dy herë në muaj: Shumëzoni shumën në \$ që paguheni dy herë në muaj herë 24 = të ardhurat vjetore
- Një herë në muaj: Shumëzoni shumën në \$ që paguheni për javë x 12 = të ardhurat vjetore

Mos harroni

Të ardhurat nga punësimi duhet të deklarohen para zbritjes së taksave dhe parave ose zbritjeve të tjera. (Këto quhen **të ardhura bruto**). Duhet të përfshini të ardhurat bruto që merrni nga çdo punëdhënës për një vit të plotë.

[PAGE 5]

2. TË ARDHURAT NGA VETËPUNËSIMI

Të ardhurat nga vetëpunësimi janë të gjitha paratë që fitoni çdo vit nga vetëpunësimi, puna e pavarur, ose si një kontraktor i pavarur. Në aplikim përfshin shumën për një vit të plotë, duke hequr shpenzimet e ushtrimit të biznesit (**të ardhurat neto**). Nëse nuk fitoni të njëjtën shumë çdo vit, shikoni edhe faqen 6 "Vlerësimi i të ardhurave vjetore nga vetëpunësimi".

Ju ose çdokush që jeton me ju...

- Plotësoni formularë deklarimi 1099?
- Keni biznes në pronësinë tuaj?
- Punoni si ofrues shërbimi i pavarur? Për shembull: Shofer taksie që posedon/merr me qira taksinë, Stilist flokësh që merr me qira një hapësirë në një sallon bukurie.
- Bëni punë të pavarur Për shembull: Artist, shkrimtar, ose dizajner grafik i paguar drejtpërdrejt nga klientët.
- Punoni si konsulent ose **kontraktor i pavarur**? Shembuj në vazhdim.
- A bëni punë rastësore ose sezonale për fitime personale.

Për shembull: Pastruese shtëpie e paguar direkt nga pronari, kujdestare për fëmijët, paguar drejtpërdrejt nga familja, drejtimi I biznesit tuaj të kateringut gjatë sezonit të verës

Këto janë burimet e të ardhurave nga vetëpunësimi. Nëse i jeni përgjigjur me "po" njërës prej të mësipërmeve, vendos "vetë" në atë seksion të aplikimit ku shkruhet "punëdhënësi" dhe raportoni shumat e **të ardhurave neto**.

SI TË LLOGARISNI TË ARDHURAT NETO NGA VETËPUNËSIMI

1. Filloni me shumën totale të parave që futen në aktivitetin tuaj të biznesit gjatë një viti. (Në formularin e deklarimit 1099, këto janë "faturat bruto".)
2. Hiqni shpenzimet e ushtrimit të biznesit dhe çdo zbritje tjetër.
3. Këto janë të **ardhurat neto nga vetëpunësimi**.

KUSH QUHET KONTRAKTOR I PAVARUR?

Kontraktor i pavarur është dikush që punësohet nga persona të tjerë për të bërë punë të caktuara, sipas rastit. Në përgjithësi kontraktori dhe personi që e punëson atë nënshkruajnë një marrëveshje ndërmjet tyre.

Për shembull: Nicole, Lyerëse shtëpish

Nicole është lyerëse shtëpish dhe punon si **kontraktore e pavarur**. Të gjitha furçat, shkallët dhe pajisjet e tjera ajo i ka të sajat, dhe njerëzit e punësojnë atë për të lyer apartamentet. Para se të fillojë një projekt për dikë, ajo bie dakord për shumën e parave që do t'i paguhet për orë dhe nënshkruan një marrëveshje. Kur Nicole mbaron lyerjen, i tregon personit që e ka kontraktuar se sa orë ka punuar dhe ai i shkruan një çek ose i jep para në dorë.

Mos harroni

Në aplikim, shuma e të ardhurave nga vetëpunësimi duhet të jetë vlera *pas* zbritjes së shpenzimeve të ushtrimit të biznesit dhe ndalesave të tjera. Këto quhen **të ardhura neto**.

VLERËSIMI I TË ARDHURAVE VJETORE NGA VETËPUNËSIMI

Ju ndoshta nuk mund të fitoni të njëjtën shumë parash çdo vit nga vetëpunësimi. Nuk ka problem. Përdorni këto hapa për të vlerësuar të ardhurat tuaja vjetore nga vetëpunësimi.

1. Do t'ju duhen të paktën deklaratat tatimore të 3 viteve radhazi për këtë lloj pune nga vetëpunësimi. Nëse nuk keni të dhëna për 3 vite, përdorni të dhënat e 2 viteve radhazi.
2. Shihni shumat e fitimit neto në deklaratat tatimore. Në deklaratën tatimore, shihni rreshtin 12, "Të ardhurat (ose humbjet) nga biznesi"). Në formularin C të shtojcës, shini rreshtin 31, "Të ardhurat (ose humbjet) neto".
3. A mendoni se do të fitoni *të njëjtën* shumë parash këtë vit si vitet e kaluara? Nëse po, llogarisni mesataren dhe përfshini shumën në aplikim. (Shihni më poshtë se si të llogarisni mesataren e fitimit)
4. A parashikoni se shuma e parave për këtë vit do të jetë *ndryshme* nga ajo e viteve të kaluara? Nëse po, përfshini shumën që parashikoni të fitoni këtë vit.
5. Nëse keni humbur para për një vit, përdorni vlerën 0.00\$ për atë vit. Mos përdorni numra me minus. Shihni "Rreth mesatareve" më poshtë, për më shumë informacion.
6. Sigurohuni se keni dokumentet që vërtetojnë shumën që keni fituar në të kaluarën (si p.sh. deklaratat tatimore) dhe të ardhurat që mendoni se do të fitoni këtë vit (si p.sh. një vërtetim nga financieri ose menaxheri i biznesit, pasqyra financiare, buxhete, fatura, ose të dhëna të tjera).

Për shembull: Shërbim katering, David

David punon në administratë gjatë javës, por disa vjet më parë ai gjithashtu ka filluar një biznes katering gjatë fundjavave të verës për të fituar para shtesë. Aktiviteti i biznesit po zgjerohet.

Çdo vit aktiviteti i biznesit të David bën më shumë para se sa viti i kaluar: 3 vite më parë, aktiviteti i biznesit arriti 5000\$. 2 vite më parë, arriti 7000\$. Vitin e kaluar, arriti 9000\$.

Në bazë të prirjes së 3 viteve të kaluara, David parashikon të fitojë 11 000\$ këtë vit nga shërbimi i kateringut. Në aplikim kur të fusë të dhënat e të ardhurave nga vetëpunësimi, ai duhet të vendosë vlerën 11 000\$. Kjo është përveç pagës që fiton nga puna në administratë.

RRETH MESATAREVE

Nëse mendoni se këtë vit do të fitoni shumën e njëjtë që keni fituar 3 vitet e fundit, llogarisni mesataren e atyre viteve dhe futeni në aplikim. Veproni kështu:

1. Gjeni shumat e fitimit neto në deklaratat tatimore për 2 apo 3 vitet e fundit radhazi.
2. Mblidhni të gjitha këto shuma. A është ndonjë nga shumat negative (Shembull: - 924.00\$)? Nëse po, përdorni vlerën 0.00\$ për atë vit.
3. Pjesëtoni këtë numër me shumën me të cilën keni filluar biznesin. Nëse keni shuma të **3** viteve, pjesëtoni vlerën me 3 për të marrë një mesatare. Nëse keni shuma të **2** viteve, pjesëtoni vlerën me 2 për të marrë një mesatare.
4. Vendosni mesataren e fitimeve në pjesën e aplikimit "Të ardhurat nga vetëpunësimi".

3. TË ARDHURAT NGA BURIME TË TJERA

Ju ose personat me të cilët do të jetoni mund të keni të ardhura që nuk vijnë nga një punë apo nga vetëpunësimi. Nëse i merrni këto **të ardhura nga burime të tjera rregullisht**, duhet t'i shtoni dhe ato në aplikim.

A merrni ju ose çdokush që jeton me ju të ardhura rregullisht nga...?

Shënim: Përfshini të ardhurat nga fëmijët nën 18.

- Ndihma ushqimore
- Pagesat për pensione vjetore
- Rezerva të Forcave të Armatosura
- Asistenca e fëmijëve*
- Pagesa për personat me aftësi të kufizuar
- Shpërndarjet
- Dividendët
- Dhurimet. Shembuj në faqen tjetër
- Interesi nga asetet (si p.sh. llogaritë bankare ose investime të tjera). Për më shumë hollësi shihni faqen 10, "Terma ndihmëse"
- Pensioni
- Ndihma shtetërore (PA)**
- Prona me qira. Përdor të ardhurat neto nga prona e dhënë me qira
- Sigurimet shoqërore ose SSI. Përdorni shumën e plotë për çdo muaj, përpara ndalesave.
- Përfitimet e papunësisë
- Shpërblimi i punonjësit

Këto janë shembuj të të ardhurave nga burime të tjera. Nëse i jeni përgjigjur me "po" njëres prej të mësipërmeve, përfshini shumat në pjesën e aplikimit "të ardhurat nga burime të tjera".

Mbani mend

Përfshini **të ardhurat nga burimet e tjera** vetëm nëse i merrni **rregullisht** (çdo javë, çdo dy javë, çdo muaj ose çdo vit). Mos përfshini **pagesat e kryera vetëm një herë**.

Në aplikim, përfshini shumën totale të parave që merrni gjatë vitit nga secili burim. Kjo vlen edhe për rastet kur nuk do të merrni pagesë përgjatë një viti të plotë. Për shembull: Ju e merrni pagesën e papunësisë çdo javë, por e dini që këto pagesa do të përfundojnë pas pak muajsh. Përfshini shumën totale që do të merrnit në një vit nëse pagesat nuk do të ndërpriteshin. Shikoni f. 4 për të mësuar se si të llogarisni të ardhurat vjetore nga çdo pagesë e rregullt.

** A e përfitoni pagesën e pensionit ushqimor të fëmijës, të caktuar nga gjykata, dhe ndihmën shtetërore (PA)? Sigurohuni të përfshini shumën totale të paguar për pensionin ushqimor të fëmijës. Për shembull, nëse merrni pagesa tranzitore ("pass-through") shuma totale e pagesës së detyrimit ushqimor të fëmijës mund të jetë e ndryshme nga ajo e përmuajshmja.*

*** Të ardhurat tuaja nga ndihma shtetërore do të llogariten sipas rregullave për lokalitetet "e paguara". Nëse shkoni në një intervistë për konfirmimin e kualifikueshmërisë suaj, personi i autorizuar ose agjenti i marketingut do të shqyrtojnë të gjitha dokumentet tuaja për të bërë këtë përlllogaritje.*

[PAGE 8]

Çfarë janë të ardhurat nga dhurimet?

Marrja **rregullisht** e parave ose ndihmës për pagesën e faturave nga njerëz që nuk jetojnë me ju, quhet **e ardhur nga dhurimi**. Ju duhet ta përfshini këtë në llogaritjen e të ardhurave tuaja.

Për shembull:

- Prindërit tuaj paguajnë çdo muaj faturën tuaj të energjisë që është mesatarisht rreth 100\$ në muaj. Ju duhet ta përfshini pagesën prej 100\$ në muaj tek të ardhurat tuaja në aplikim.
- Një mik ose i afërm ju jep 20\$ para në dorë çdo javë për t'ju ndihmuar me shpenzimet. Ju duhet ta përfshini pagesën prej 20\$ në javë tek të ardhurat tuaja në aplikim.

Nëse ftoheni në një intervistë për konfirmimin e kualifikueshmërisë suaj, do t'ju nevojiten dokumente për të vërtetuar marrjen rregullisht të këtij dhurimi. Për shembull, sigurohuni që të depozitoni menjëherë pagesat në dorë në llogarinë tuaj bankare në mënyrë që lëvizjet e llogarisë të vërtetojnë që paguheni rregullisht. Ju mund të vërtetoni që ua paguan dikush tjetër faturat me anë të kopjeve të çeqeve të arkëtuara.

Shënim: Të mëposhtmet nuk janë dhurime dhe nuk duhet të përfshihen në llogaritjen e të ardhurave tuaja: (1) dhurime ushqimesh për fëmijët në familjen tuaj, (2) vlera e hequr ose e reduktuar e vaktit të drekës në shkollë, ose (3) vlera e vakteve që u ofrohen të moshuarve ose personave në nevojë.

TË ARDHURA QË NUK PËRFSHIHEN

Ka disa përjashtime për atë çfarë mund të përfshihet te të ardhurat:

- Të ardhurat nga punësimi për fëmijët nën 18 vjeç
- Çdo e ardhur mbi 480\$ e fituar nga një **student** me kohë të plotë, I mbajtur nga familja dhe mbi 18 vjeç
- Pagesat gjithëpërfshirëse, si një vlerë e vetme. *Për shembull: Pagesat e sigurimeve, Trashëgimia*

- Të ardhurat e papërsëritura, periodike ose sporadike (duke përfshirë **dhurimet e papërsëritura**)
- Pagesat ose rimbursimet për shpenzimet mjekësore
- Pagesat për kujdesin ndaj fëmijëve të birësuar
- Asistenca për studentët që i paguhet studentit ose institucionit arsimor
- Vlera në dollar e ndihmës ushqimore ose SNAP
- Dhurimet e ushqimeve për fëmijët në familjen tuaj
- Vlera e hequr ose e reduktuar e vaktit të drekës në shkollë
- Vlera e vakteve që u ofrohen të moshuarve ose personave në nevojë

Mos i përfshini këto elementë në llogaritjen e të ardhurave tuaja.

[PAGE 9]

PYETJE TË SHPESHTA

Të ardhurat nga punësimi

Pse duhet të llogaristë ardhurat e mia vjetore? Nuk mund të vendos të ardhurat e vitit të kaluar?

Ju dhe personat që jetojnë me ju do të **kualifikoheni** në bazë të të ardhurave të fituara në vazhdim. Do të ishte ide e mirë të shihnit deklaratën tatimore të vitit të kaluar por kjo nuk është e mjaftueshme. Çdo vit është i ndryshëm. Kjo është arsyeja pse duhet të vendosni shumën që fitoni aktualisht dhe sa shpesh paguheni. Kjo është gjithashtu arsyeja pse duhet të përfshini bonuset që merrni ose prisni të merrni **rregullisht**, dhe **të ardhurat nga burime të tjera**.

Vajza ime në moshë madhore është *studente* me kohë të plotë që punon pas shkolle. A llogariten të ardhurat e saj?

Nëse një student me kohë të plotë, mbi 18 vjeç, mbahet nga prindërit ose kujdestarët, vetëm 480\$ të ***të ardhurave të tij/saj nga punësimi*** llogariten si të ardhura.

Paguhem me para në dorë. Si mund ta vërtetoj që këto janë të ardhurat e mia?

Është e rëndësishme të ruani të dhënat e pagesave të marra me para në dorë. Çdo herë që paguheni me para në dorë, shkruani shumën e parave, datën dhe emrin e personit që ju ka paguar. Ruajini këto të dhëna të pagesave me para në dorë në një vend të sigurt.

Nëse keni llogari bankare, depozitoni paratë menjëherë. Kjo bëhet në mënyrë që banka të dokumentojë rregullsinë e pagesave tuaja. Nuk ka problem nëse ju duhet t'i tërhiqni përsëri paratë. Pasqyra e llogarisë suaj e shfaq gjithsesi depozitim të bërë.

Mos harroni: Nëse të ardhurat që fitoni në para në dorë janë mbi normë, këtë duhet ta raportoni gjithashtu në deklaratën tuaj tatimore. Shuma do të tregohet në formularin tuaj të deklarimit.

Pagesat që marr janë *rastësore ose episodike*. Si t'i llogaris të ardhurat e mia?

Llogaritja e të ardhurave vjetore mund të jetë e vështirë nëse nuk paguheni ***rregullisht***. Puna gjatë fundjavave si furnizues ushqimesh për të fituar më shumë para, punët e përditshme në sektorin e kujdesit shëndetësor, punët e përkohshme dhe puna si zëvendësues janë shembuj të punëve rastësore ose episodike që bëni për një punëdhënës.

A keni marrë të ardhura nga punë rastësore ose episodike gjatë 3 viteve të fundit? Nëse po, shtoni shumën e fituar për të tre vitet së bashku dhe pjesëtojeni me 3. Ky numër paraqet të ardhurat tuaja mesatare vjetore nga ajo punë.

Më pas bëni një llogaritje të përafërt të shumës që do të merrni këtë vit nga e njëjta lloj pune. Krahasojeni këtë numër me mesataren tuaj vjetore. Cila është më e lartë? Vendosni numrin më të madh në seksionin "të ardhurat nga punësimi" të aplikimit tuaj.

Çfarë ndodh nëse të ardhurat e mia ndryshojnë pas aplikimit dhe ftohem në një intervistë për konfirmimin e kualifikueshmërisë në bazë të të ardhurave familjare?

Ruani të gjitha dokumentet dhe të dhënat që konfirmojnë të ardhurat tuaja aktuale. Nëse të ardhurat tuaja ndryshojnë (për shembull, ndryshoni punë ose rriteni në detyrë), sillni edhe dokumente që tregojnë se sa do të paguheni në vazhdimësi. Personi i autorizuar ose agjenti i marketingut do të rillogarisë të ardhurat tuaja.

Të ardhurat nga vetëpunësimi

Jam ftuar në një intervistë për konfirmimin e kualifikueshmërisë në bazë të të ardhurave familjare për strehim të përbalueshëm. Çfarë dokumentesh më duhen për të konfirmuar të ardhurat e mia nga vetëpunësimi?

Do t'ju duhet të konfirmoni të ardhurat e fituara në të kaluarën nga kjo lloj pune dhe të ardhurat që prisni të fitoni këtë vit.

Për të konfirmuar të ardhurat e kaluara sillni deklaratimet tatimore të 3 viteve të fundit për vetëpunësimin në këtë lloj pune. Nëse nuk dispononi informacione për 3 vite mund të sillni vetëm ato të 2 viteve të fundit.

Për të konfirmuar të ardhurat që prisni të fitoni këtë vit sillni një vërtetim nga kontabilisti ose menaxheri i aktivitetit, pasqyra financiare, buxhete, fatura ose informacione të tjera që vërtetojnë shumën që pretendoni të merrni.

Po nëse jam i vetëpunësuar në një lloj të caktuar pune prej më pak se 2 vitesh?

Do t'ju nevojiten dokumente që vërtetojnë se, nga data e intervistës, keni qenë i vetëpunësuar në këtë lloj pune prej 2 vitesh ose më shumë. Nëse nuk e vërtetoni dot këtë informacion për 2 vitet e fundit, ka mundësi të mos kualifikoheni.

Edhe nëse mendoni kështu, duhet gjithsesi t'i përfshini **të ardhurat tuaja neto nga vetëpunësimi** në aplikim. Mos lini asnjë të ardhur pa përfshirë. Mund të kalojnë muaj deri sa të merrni vesh

nëse numri juaj është përzgjedhur nga shorti, kështu që ndoshta deri në atë moment do të jenë bërë 2 vite që merrni të ardhura nga vetëpunësimi. Sigurohuni të sillni në intervistë dokumente që tregojnë shumën e të ardhurave të fituara deri në atë moment nga ky lloj vetëpunësimi dhe shumën e të ardhurave që do të fitoni këtë vit.

TERMA NDIHMËSE

Asete: Asetet janë sende me vlerë që mund të konvertohen në para. Llogaria e kursimit është një aset në para. Banka paguan interes për këtë aset. Interesi përbën të ardhurat nga ky aset. Shembuj të tjerë: aksionet, obligacionet, fondet e përbashkëta, instrumentet e tregut të parasë. Shihni **Interesat nga Asetet**, më poshtë, për më shumë informacion.

I kualifikueshëm/Kualifikueshmëri: Të ardhurat tuaja duhet të jenë midis kufijve të caktuar dhe të përmbushin kushtet e tjera të aplikimit për t'u kualifikuar për strehimin e përbalueshëm. Kërkesat e tjera përfshijnë sigurimin e dokumenteve që vërtetojnë të ardhurat tuaja dhe kalimin me sukses të verifikimit të kreditit dhe të precedentëve. Nëse ju dhe njerëzit me të cilët do të jetoni i përmbushin të gjitha kushtet, atëherë ju jeni të kualifikueshëm.

Interesi nga asetet: Nëse shkoni në një intervistë të konfirmimit të kualifikueshmërisë, personi i autorizuar ose agjenti i marketingut do të llogarisin të ardhurat tuaja nga interesat e aseteve si llogaritë bankare dhe investimet e tjera. Nëse të gjitha asetet tuaja të tjera kanë një vlerë më pak se 5000\$, interesi i tyre i shtohet të ardhurave tuaja. Nëse të gjitha asetet tuaja të tjera kanë një vlerë më shumë se 5000\$, interesi i tyre ose 0.06% e vlerës së tyre i shtohet të ardhurave tuaja, cilado qoftë shuma më e lartë.

Intervista për konfirmimin e kualifikueshmërisë: Në përfundim të afatit të aplikimit, të gjitha aplikimet renditen në mënyrë rastësore. Aplikimet rishikohen duke nisur nga fillimi i listës dhe nëse japin përshtypjen se janë të kualifikueshme, aplikantët thirren në intervistë për të vazhduar me procesin e shqyrtimit. Nëse ftoheni në intervistë, do t'ju nevojiten me vete dokumente që konfirmojnë të ardhurat tuaja.

Kontraktor i pavarur: Një person ose biznes që punësohet nga njerëz të tjerë kur nevojitet për të bërë punë të caktuara. Zakonisht kontraktori dhe personi që e punëson atë nënshkruajnë një marrëveshje ose kontratë.

Pagesa që kryhen vetëm një herë: Të ardhura të paguara jo rregullisht në të kaluarën dhe që nuk keni pritshmëri t'i merrni përsëri në të ardhmen. Këto para nuk përfshihen në llogaritjen e të ardhurave.

Strehim i përballueshëm: Strehimi në qytetin e Nju Jorkut për personat me të ardhura nën normë. Zakonisht, strehimi quhet "i përballueshëm" nëse kostoja e qirasë ose strehimit është afërsisht sa një e treta e të ardhurave të një personi.

Student: Një person me statusin e një studenti me kohë të plotë (sipas shkollës që frekuenton) për 5 muaj të vitit kalendarik. Nuk është e nevojshme që 5 muajt të jenë të njëpasnjëshëm. Vetëm 480\$ të të ardhurave nga punësimi i një studenti me kohë të plotë, që mbahet nga familja, përfshihen në llogaritjen e të ardhurave.

Të ardhurat bruto: Fitimet tuaja vjetore (çdo vit), pagat, pagesat ose para të tjera që merrni nga puna apo burimet e tjera, pa zbritur taksat. Të ardhurat bruto janë zakonisht më të larta se paga që çoni në shtëpi. Shumica e njerëzve i raportojnë të ardhurat bruto në aplikimet e tyre. Ndërsa, personat e vetëpunësuar raportojnë të ardhurat neto nga vetëpunësimi.

Të ardhurat e marra rregullisht: Nëse të ardhurat nga çfarëdo lloj burimi merren rregullisht, do të thotë se paguheni në intervale të rregullta dhe të parashikueshme. Të ardhurat që merren çdo ditë, çdo javë, çdo 2 javë, dy herë në muaj, një herë në muaj, çdo tre muaj ose çdo vit janë shembuj të të ardhurave të marra rregullisht.

Të ardhurat neto: Shuma e të ardhurave të marra pas zbritjes së taksave, shpenzimeve dhe ndalesave të tjera. Të ardhurat neto përdoren për të llogaritur të ardhurat nga vetëpunësimi.

Të ardhurat nga burime të tjera: Të ardhurat që merrni rregullisht nga burime të tjera përveç punës. Për shembull, sigurimet shoqërore ose përfitimet nga statusi i veteranit, ndihma shtetërore apo pagesa e detyrimit ushqimor të fëmijës.

Të ardhurat nga dhurimet: Të ardhura që merrni rregullisht nga dikush që nuk jeton me ju. Për shembull: Prindërit ju paguajnë çdo muaj faturat ose një mik apo i afërm ju dërgon rregullisht një çek për t'ju ndihmuar me blerjen e ushqimeve dhe shpenzimet e tjera. Të ardhurat nga dhurimet mund të jenë jo domosdoshmërisht në formë parash.

Të ardhurat nga punësimi: Të ardhurat për punën që bëni për një punëdhënës (jo si i vetëpunësuar). Të ardhurat bruto përdoren për raportimin e të ardhurave nga punësimi.

Të ardhurat nga vetëpunësimi: Të ardhurat që fitoni nga puna si i vetëpunësuar, biznesi personal ose ofrimi i shërbimeve. Këto përfshijnë punën e pavarur, kontraktimin e pavarur si dhe ofrimin e shërbimeve. Në aplikim, të ardhurat neto përdoren për të ardhurat nga vetëpunësimi. Nëse të ardhurat tuaja neto janë 400\$ në vit ose më shumë, duhet t'i raportoni ato në aplikim. *Shënim: nëse aktiviteti juaj hyn në kategorinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, të ardhurat bruto të biznesit të raportuara në formularin K-1 i shtohen pagave bruto të formularit W-2.*

Të ardhurat rastësore ose episodike: Të ardhurat periodike që nuk paguhen në intervale kohe të rregullta ose të parashikueshme. Punët e përkohshme, punët sezonale ose punët si zëvendësues janë shembuj të punëve periodike të paguara në mënyrë rastësore ose episodike.

Të ardhurat vjetore: Shuma e parave që ju paguhet në një vit, e llogaritur nga të ardhurat bruto nga punësimi, të ardhurat neto nga vetëpunësimi dhe të ardhurat nga burimet e tjera.

Të ardhurat: Fitimet, pagat, pagesat ose para të tjera që merrni.

[BACK PAGE FOOTER]

[NYC Housing Connect](#)

Gjeni dhe aplikoni për strehim të përballueshëm

New York City Department of Housing Preservation and Development

New York City Housing and Development Corporation

Facebook: www.facebook.com/NYCHPD

Twitter: @nychousing

Faqja zyrtare e internetit: www.nyc.gov/hpd

Vizitoni www.nyc.gov/housingconnect për më shumë informacione rreth mënyrës së aplikimit online.

Ky dokument është vetëm me natyrë informuese. Ky nuk është një aplikim për strehim të përballueshëm. Plotësimi i këtij dokumenti nuk ju garanton se do të përfitoni një njësi banimi të përballueshme.